

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	201/24
Nr. i fq. / Br. st.	- 6 -
Data: / Datum	15.11.2024
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN**

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e IX-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21 tetor 2024
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifë (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollë dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Rruka Mlinaku (Nënkyryetare e komunës), drejtoret e drejtoreve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Siç e keni parë, na ka ardhur edhe një pikë shtesë: "Informatë për faljen e borxheve në taksa afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017".

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.09.2024
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025
4. Shqyrtimi i Informatës për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë
5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktivitetave kulturore, rimore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun
6. Shqyrtimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ "Zëri i RAE"
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë
8. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e librit "Vushtrria në dokumentet osmane"
9. Shqyrtimi i Informatës për faljen e borxheve në taksa afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017
10. Pyetje dhe përgjigje

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.09.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashëtë (6) vota “për”, aprovoi procesverbalin e datës 13.09.2024.

2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – lidhur me këtë raport, desha të ndalem tek kategoria <Subvencione dhe transfere>, kod 200, ku kanë qenë të planifikuara 1,126,279.78€, kurse të realizuara janë 976,627.38€ ose 87%. Kjo është një shkallë e lartë e realizimit deri në këtë periudhë. Megjithatë, nuk qëndrojnë pretendimet që po jepen nga disa drejtori se është shpenzuar në tërësi buxheti i subvencioneve, sepse kemi marrë shumë ankesa nga qytetarët se nuk është duke u kryer pagesa për fëmijët e porsalindur (njëra nga kategoritë e subvencioneve). Ndërkohë, buxheti i mbetur tek kategoria e subvencioneve është 262,052.40€. Prandaj, ai kërkoi nga drejtori i financave, por edhe nga drejtoritë përkatëse që të zbatohen vendimet e kuvendit komunal lidhur me pagesën e subvencioneve sipas vendimeve që janë në fuqi.

Ai tha se nga disa informata jozyrtare që ka marrë, as klubit të futbollit “Vushtria” nuk i janë ekzekutuar mjetet sipas vendimit të kuvendit të komunës. Andaj, këto mjete të mbetur nga subvencionet të përdoren duke zbatuar vendimet e kuvendit, e mos t’i merr përmbaruesi mjetet në këtë kategori, por në mallra e shërbime ku ka mbetje më të mëdha.

Mehollı tha se për nëntë muaj janë shpenzuar 98% e mjeteve në kategorinë <Paga dhe mëditje>. Po shohim vazhdimisht që edhe komunat tjera po mbesin pa buxhet për shkak të kontratës kolektive. Kanë mbetur edhe tre muaj dhe ka mundësi që deri në fund të vitit, Vushtria mos të ketë buxhet të mjaftueshëm për paga. Cilët janë hapat që keni ndërmarrë në këtë drejtim? Kjo për shkak se punëtorët mund të mbesin pa paga.

Tek kategoria e investimeve kapitale, përqindja e realizimit nuk është e kënaqshme, për dallim me kategoritë tjera. Shpenzimet komunale e kanë një planifikim nga viti paraprak, edhe mos me u shpenzu shumë është mirë. Tek investimet kapitale, 56% për nëntë muaj nuk është e mjaftueshme, e sidomos ku nga e njëjtë kategori janë marrë mjete nga procedurat përbirimore. Ai tha se kjo përqindje është dashur të jetë shumë më e madhe.

Melihate Basholli-Latifı, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – dua të ju informojë se vendimet lidhur me KF “Vushtria” dhe KHF “Samadrexha” na janë kthyer të jashtëligjshme dhe na është kërkuar që të rishqyrtohen dhe shfuqizohen. Kështu që në mbledhjen e kuvendit do t’i kemi për rishqyrtim këto dy pika.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – dua të ndalem tek shpenzimet në kategorinë përmallra dhe shërbime dhe tek subvencionet. Ajo tha se çdo vit po rriten shpenzimet përudhëtime jashtë vendit dhe brenda vendit, akomodimet. Këto shpenzime janë dyfishuar, por edhe trefishuar. Mëditjet jashtë vendit, vitin e kaluar kanë qenë 4,407.80€, kurse në të njëjtën periudhë këtë vit janë 12,053.89€. A ka mundësi të na jepni sqarime pse janë rritur këto shpenzime. Kush po shkon kaq shpesh jashtë vendit? Pastaj, shpenzimet e telefonisë mobile janë rritur dukshëm nga viti i kaluar. Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), në vitin e kaluar kanë qenë 113,037.38€, kurse këtë vit janë vetëm 46,310.34€. Kisha dashur që të jetë i pranishëm drejtori i prokurimit dhe të na njoftojë se çka është problemi, që kjo kontratë nuk po arrin të përfundohet që sa muaj. Ajo tha se është muaji i dytë që kemi filluar punën në kopshtin “IP Foleja 2” dhe fëmijët as nuk kanë oriz, as pasul, as pemë e as perime. Prandaj, kjo gjendje e njëjtë është edhe në dy kopshtet tjera “IP Foleja 1” dhe “IP Foleja 3”. Jam vet aty dhe i bie keq me fol për vendin ku punoj, por është për

keqardhje dhe nuk është në rregull të mburret drejtori i prokurimit e mos të bëjë zgjidhje që disa muaj.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sa i përket raportit nëntëmujor, të gjitha informatat janë të sakta që janë marrë nga sistemi i menaxhimit të freebalancit, sistemi i menaxhimit financiar. Tek subvencionet, pasqyra është ashtu qysh e kemi paraqitur. Ai tha se këtë vit kemi pasur ngecje me inkasim të të hyrave për shkak të faljes së borxhit të tatimit në pronë. Jashari tha se prioritet ju kemi dhënë projekteve që janë afër nënshkrimit të kontratës. Një pjesë të mjetave i kemi pasur të planifikuar nga granti, kurse një pjesë nga të hyrat vetanake. Lidhur me pagesën për fëmijët e porsalindur, ai tha se është e vërtetë që nuk po paguhën. Këtë muaj, zyrtarja i ka përgatitur lëndë për ekzekutimin e këtyre pagesave, nga mjetet që janë në shëndetësi dhe pjesa tjetër aty ku ka mjete të lira nëpër drejtori me vendim të kryetarit.

Sa i përket investimeve kapitale, ai tha se realizimi është sipas planit dinamik, edhe përkundër vështirësive rreth vendimeve gjyqësore, që një pjesë bukur të madhe i kanë marrë nga investimet kapitale dhe një pjesë nga pagat dhe mëditjet. Mirëpo, sa për informimin tuaj, që disa ditë e kemi sistemin të bllokuar nga ministria, për shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga arsimi dhe shëndetësia.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Informatës përfundimtare me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – të bëhen disa përmirësime teknike në faqen 2 dhe 3. Unë pata një pyetje jashtë materialit: A parashihni ndërlidhje të aktiviteteve në mes juve si drejtori dhe Drejtorisë për Arsim? Sepse, mendoj se muzeu etnografik, arkivi historik, nganjëherë edhe teatri, trashëgimia kulturore, që shkollat sipas radhës të bëjnë vizitë nëpër institucionet kulturore.

Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – tha se ende nuk është bërë pranimi teknik i muzeut. Kemi kërkesa si drejtori për vizitë të nxënësve. Por, do ta kam parasysh këtë kërkesë që me Drejtorinë për Arsim të kemi një bashkëpunim në këtë drejtim. Sa i përket gabimeve teknike në informatë, për kuvend do ta përmirësojmë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – dua ta përgëzoj drejtorin dhe drejtorinë për këtë informatë dhe se punëtorët e kësaj drejtorie a jepin maksimumin për realizimin e aktiviteteve.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i RAE”.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se në bazë të kësaj draft-marrëveshjeje, Komuna e Vushtrrisë bashkëfinancon në vlerë prej 80 mijë euro për ndërtimin e shtëpive për komunitetin RAE. Nuk jemi kundër ndërtimit të shtëpive të këtij komuniteti, por ka mjaft qytetarë të komunës sonë nga komuniteti shumicë shqiptar që jetojnë në kushte të rënda dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit. Kjo qeverisje për tri vite ka bërë shumë pak ose fare lidhur me këtë aspekt. Prandaj, të mos përfshihet komuniteti shumicë në këtë draft-marrëveshje, nuk është e drejtë.

Sa kam qenë drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për tri vite, ju kemi bërë zgjidhje 20-30 familjeve në secilin vit në forma të ndryshme. Disa familjeve u janë ndërtuar shtëpi, disa familjeve tjera u janë dhuruar banesa në bashkëpunim me organizatën “Jetimat e Ballkanit” dhe organizata tjera. Në qeverisjen e juaj, kjo çështje ka ngetur shumë, sepse në bazë të informatave që kemi marrë nga terreni, shumë pak keni bërë zgjidhje për familjet e pastrehë.

Melihate Basholli-Latifı, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se kjo ka qenë nevojë edhe në mandatet e mëhershme dhe jo vetëm në mandatin tuaj. Në mandatin e Bajram Mulaku ka pasur ndërtimë të shtëpive goxha shumë, nuk e di saktë numrin. Pasta, kanë vazhduar këto ndërtimë. Në këtë mandat, komuna paguan qira për familjet që kanë nevojë.

Hava Rruka Mlinaku, Nënkyrytare e komunës – tha se ka vazhduar subvencionimi i familjeve në nevojë, numrin saktë nuk e di, por përafërsisht janë diku 20 familje. Po ashtu, kemi marrëveshje me shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e disa shtëpive. Prandaj, nuk është që nuk kemi punuar në këtë drejtim. Po ashtu, e keni para jush një draft-marrëveshje për ndërtim të pesë shtëpive për komunitetin RAE në bashkëpunim me OJQ “Zëri i RAE”.

Violetë Thaçi, OJQ “Zëri i RAE”. – i njoftoi të pranishmit lidhur me draft-marrëveshjen. Unë pajtohem me anëtarin e komitetit, i cili tha që nuk ka asnjë shtëpi nga komuniteti shqiptar në këtë projekt. Por, komuniteti RAE jeton në një vendbanim joformal në fshatin Prelluzhë dhe se shtëpitë e tyre janë të ndërtuara në prona komunale. Andaj, ne si organizatë kemi pasur bashkëpunim edhe më herët me komunën për ndërtim të shtëpive edhe të komunitetit shqiptar, por edhe nga komuniteti RAE në vitin 2015 ose 2016. Sipas kërkësës së donatorëve, jemi të interesuar që këtë vendbanim joformal në Prelluzhë ta formalizojmë gradualisht në mënyrë që të mos vazhdojë uzurpimi i pronës komunale. Po besojmë që në vitin 2025 në bashkëpunim me komunën të bëjmë subvencionimin e banimit social.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – e para që nuk është në rregull me këtë propozim-vendim është mungesa e prezencës së drejtorit të kadastrit për të dhënë sqarime. Për 45 vjet t'i jepet në shfrytëzim KEDS-it me një pagesë prej 200 euro. KEDS-in na po e paguajmë, po e paguan edhe komuna. Prandaj, në këtë rast komuna duhet të përfitojë. Ai pyeti se kjo pagesë a është e njëherershme apo çdo muaj? Unë jam kundër kësaj forme, pa pasur përfitim komuna për 45 vjet nga KEDS-i për shfrytëzimin e pronës.

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – sqaroi se bëhet fjalë për pronat në Stanoc të Epërm, ku do të vendoset stacioni i pompimit përfundim me ujë dhe nevojitet minimumi 40KË. Me këtë projekt, do të furnizohen me ujë të pjes edhe tri Dumnicat.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, dy (2) “kundër” rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Shqyrtimi i kërkesës përkrahje financiare për botimin e librit “Vushtrria në dokumentet osmane”.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se nuk është kundër kësaj kërkese, por se di a kemi mjete financiare për ta mbështetur financimin e këtij libri. Ajo tha se në muajin nëntor të vitit të kaluar, e kemi marrë një vendim përkrahje financiare përvend të komunës në vlerë prej 2000€. Ajo pyeti se a është ekzekutuar kjo shumë financiare?

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – ai tha se sa jam në dijeni drejtorët zëvendësohen me drejtorë, kurse zyrtari nuk ka të drejtë të nënshkruajë përdrejtorin dhe është tejkalim i kompetencave. Po ashtu, kësaj kërkese ka qenë mirë me ja bashkëngjitet një rezume se çka do të përbajë ky libër apo hulumtimi. Nuk e dimë se a po e mbështesim hulumtimin apo botimin dhe se a do i dhurohen komunës në fund ndonjë ekzemplarë të librit.

Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – tha se pas aprovimit në kuvend, pastaj bëhet marrëveshja se a do përkrahet hulumtimi apo edhe botimi. Besoj që bibliotekës do i dhurohen falas disa libra, sepse ne po e financojmë. Sa i përket nënshkrimit, përvend do ta nënshkruajë aktin përcjellës dhe do ta përcjellim. Sa e di, mjetet financiare do të paguhen me buxhetin e vitit 2025, e jo në këtë vit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që materiali të na vjen i nënshkruar nga drejtori dhe të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Shqyrtimi i Informatës përfaljen e borxheve në taksa afariste përfundit gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi se që disa vite po na përcillen obligimet e papaguara të taksës në biznese. Ai tha se në fillim kur janë hapur bizneset janë ngarkuar automatikisht me taksë. Shumë komuna kanë filluar faljen e këtyre borxheve, sepse kemi rekomandim çdo vit nga auditori gjeneral.

Fatmire Cecelia, anëtar e KPF-së – pyeti se a bëhet fjalë për biznesc që janë aktive apo janë shuar. Ajo tha se po shoh këtu bastore, por sa kam informacione ato punojnë ilegalisht. Nëse bizneset nuk janë shuar, pse t'ua falim borxhet.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – këto janë pasqyra të qarta se si është menaxhuar me komunën nga viti 2000-2017. Nëse asgjë nuk ka ndodhë, për këto vite me ose pa qëllim, duke mos dashur apo mos arritur, komuna është dëmtuar në të hyra për 473,025.00€, të cilat ka qenë e obliguar që t'i inkasojë këto të hyra. Kjo është një pasqyrë e qartë se si është punuar në Drejtorinë për Inspektime. Ne mund t'i falim këto borxhe, por komuna këtyre bizneseve nuk ka çka t'ju bëjë, sepse borxhi është parashkruar. Sikur të kishte shtet normal, personat përgjegjës është dashur të hetohen për dëmet që i kanë shkaktuar komunës. Jam i bindur që komuna nuk ka iniciuar as procedura për zyrtarët që kanë qenë përgjegjës.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se të gjitha komunat e kanë të njëjtën problematikë të borxheve të vjetra, ku disa prej tyre kanë marrë vendim t'i falin këto borxhe. Prandaj, edhe ne e kemi parë të arsyeshme ta bëjmë një gjë të tillë, në mënyrë që mos të na përsëriten rekomandimet nga auditori çdo vit. Për kuvend do ta përgatisim edhe propozim-vendimin dhe ju jeni ata që vendosni.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se mirë do të ishte që komuna të provoj ta nxjerr borxhin, ku ndoshta ndonjëri prej tyre ka vullnet që ta paguaj borxhin, pavarësisht asaj që e di se në gjykatë e fiton rastin. Po ashtu, është mirë që këta operatorë me i fut në listë të zezë, si operator të papërgjegjshëm, që të mos marrin tenderë nga komuna, sepse kanë borxhe.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

10. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **11:50**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe KPF-së